KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI
19 22

kyrias

Numër 2, 2024

Revistë periodike shkencore-informative

Botim i Kolegjit Universitar "Qiriazi"



Manastiri i falun...

Pse ta trajtojmë si "unike", mbrojtjen e hebrenjve në Shqipëri

KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI

kyrias

NR 2, 2024 "REVISTË PERIODIKE SHKENCORE-INFORMATIVE".
BOTIM I KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

KYRIAS- Është një revistë shumëdisiplinare shkencore-informative e Kolegjit Universitar Qiriazi.
KYRIAS është revistë dygjuhëshe (shqip dhe anglisht) dhe publikohet çdo gjashtëmujor.
Kjo revistë është një burim informacioni me qasje të hapur.

© KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI – TIRANË, SHQIPËRI

This is a multidisciplinary scientific-informative journal of Qiriazi University College.
KYRIAS is a bilingual (Albanian and English) journal, and is published semi-annually.
This Journal is an Open Access source of information.

© Published by: QIRIAZI UNIVERSITY COLLEGE – TIRANA, ALBANIA

kyrias@qiriazi.edu.al
+355 672070313

Çmimi/ Price 500 ALL

Kryeredaktori: / Editor-in-Chief: Dr. Gjovalin Gjeloshi
Redaktor: / Editor: PhD. Viliem Kurtulaj

Bordi Editorial: / Editorial Board:
Prof. Dr. Hamit Boriçi, Albanian University, Tiranë
Akademik, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj Akademia e Shkencave e RSH
Prof. Dr. Abdyl Sinani, Kolegji Universitar Qiriazi
Prof. Dr. Vejsel Rizvanolli, Kolegji Universitar Qiriazi
PhD. Viliem Kurtulaj, Kolegji Universitar Qiriazi

Komiteti Shkencor: / Scientific Committee:
Prof. Dr. Maksim Meço, Kolegji Universitar Qiriazi.
Prof. Dr. Halit Xhafa, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Prof. Dr. Ylli Zhurda, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë,
Prof. Dr. Dr. Basil Schader, Shkolla e Lartë Pedagogjike, Zyrih, Zvicër
Prof. Asc. Dr. Arif Atak, Bursa Uludag University, Bursa Turqi
Prof. Dr. Skender Asani, ITKSHSH, Shkup, Maqedonia e Veriut.
Dr. Mark Camaj, Universiteti Shtetëror Nikshiq, Mali i Zi
Prof. Asc. Dr. Enida Bozheku, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Gurakuç Kuçi, Instituti i Sigurisë "Oktapod", Prishtinë, Kosovë
Prof.Dr. Arben Verçuni, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Dr. Meri Kraja, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Gerta Gjeta, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Valentina Memini, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Marsela Resulaj, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Erjona Fusha, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Prof.Asc. Dr. Besim Beqaj, Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Dr. Altin Kulli, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Sadri Ramabaja, Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, Prishtinë, Kosovë
Dr. Gjovalin Gjeloshi, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë.

Design: Hekuran Koka

TIRANË/TIRANA, 2024

Dukuri dhe problematika të migrimit në Republikën e Shqipërisë pas vitit 1990

Dr. Erjona Fusha
erjona.fusha@qiriazi.edu.al
Drejtuese e Departamentit të Edukimit,
Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv



Hyrje

Një nga dukuritë më të rëndësishme ndikuese në urbanizimin e shoqërisë shqiptare të pas vitit 1990, është migrimi i brendshëm. Transformimet politike dhe ekonomike që ndodhën në shoqërinë shqiptare në vitet 1990-1991 u shoqëruan me një sërë dukurish demografike, sociale dhe kulturore. Migrimi i brendshëm në Republikën e Shqipërisë ka nxitur një proces të pakontrolluar urbanizimi dhe zhvillimi të zonave informale. Të çmotivuar për të jetuar në fshat, shumica e e njerëzve që banonin në fshat, veçanërisht të rinjtë, i kanë patur dhe i kanë sytë nga qyteti, ku ata shpresojnë të sigurojnë një mënyrë jetese më të mirë, më shumë kohë të lirë në dispozicion dhe më shumë mundësi për ta kaluar atë në veprimtari të shumëllojshme argëtuese, artistike e sportive. Gjithashtu ata dëshirojnë të çlirohen prej paragjykimeve, thashethemeve, të jenë më të pavarur, jo vetëm nga tradita kulturore, por edhe nga ndikimet herë-herë "bezdisëse" të të afërmve në jetën e tyre vetjake.

Analiza dhe gjetje

Po t'i referohemi shoqërisë shqiptare, paraqitet një sfond historik i veçantë i lëvizjeve migratore në Republikën e Shqipërisë. Në librin "Sociologji rurale" të Doc. Dr. Elidiana Canaj shkruhet se "vitet 1923-1945, ka lëvizje masive të popullsisë brenda vendit nga zonat e thella drejt bregdetit (*Canaj, E; Mazniku, L., 2008:338*).

Pas vitit 1946 ka një ndryshim të trendit të lëvizjes së popullsisë brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, trend i cili përcaktoi edhe përqindjen e popullsisë urbane të saj. Gjatë viteve 1947-1964, sipas sociologut Zyhdi Dervishi, krahas 24 qyteteve të themeluara në mijëvjeçarin e parë pas Krishtit, deri në fund të shekullit XIX, u shtuan edhe 26 qytete të reja industriale. Ndërsa gjatë viteve 1970 dhe 1980, politika e partisë-shtet për lëvizjen e popullsisë ndryshoi rrënjësisht. Strukturat partiake e shtetërore përkatëse, jo vetëm nuk e nxisnin më zhvendosjen e popullsisë nga fshati në drejtim të qytetit, por edhe frenonin e kontrollonin me rreptësi lëvizje të tilla (*Dervishi, Z., 2001:34*).

Ndërsa pas vitit 1990, popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë lëviz e lirë si brenda ashtu dhe jashtw kufijve të vendit. Gjatë kësaj periudhe kemi shtim të numrit të popullsisë që

banonte të qytete dhe e procesit të shpopullimit të fshatit. Në fokus të këtij punimi do të jetë lëvizje e lirë migratore nga qytete dhe fshatra të ndryshëm drejt kryeqytetit pas vitit 1990, duke u përqwndruar në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, si qyteti me popullsinë më të madhe urbane në vend. Në shumë aspekte Tirana dhe rrethinat e saj po formësohet si zonë statistikore metropolitane (MSA), e cila po zgjerohet me ritme të shpejta, veçanërisht në drejtim të bregdetit. Kjo zonë pritet të bashkohet me zonën metropolitane të Durrësit (*Po aty:35*).

Në vitin 2018, rreth 55.00 për qind e popullsisë të të gjithë botës jetonin në zona urbane, përafërsisht 4.2 miliardë banorë (https://www.un.org/development/population/ , cituar më 16.02.2020). Deri në vitin 2030 pritet që numri i popullsisë urbane të rritet me 3-fish, duke e çuar në 60 për qind të popullsisë të përgjithshme të të gjithë botës. Rritjet më të mëdha do të jenë në vendet në zhvillim aty ku do të krijohen megaqytetet (*Gottdienet, M., 2011:1*).

Tirana si qytet shtrihet në një sipërfaqe prej 31 km2 dhe brenda saj përfshihen 14 njësi administrative (*https://sq.wikipedia.org/wiki/Tiranacituar më 09.04.2021*). Deri në vitin 2018 ishin 11 Njësi Administative të qytetit, më pas u krijuan njësitë adminsitative Nr. 12, Nr. 13 dhe Nr. 14. Njësia Administrative Nr. 12 përfshin zonën e Freskut dhe Qesarakës, Njësia Administrative Nr. 13 përfshin zonat e Selitës, Kodrës së Diellit dhe liqenit të Thatë dhe Njësia Administrative Nr. 14 përfshin zonat e Kasharit dhe Unazën e Re. Zona këto në Tiranë, të cilat më parë administroheshin nga komunat dhe në vitet e fundit në to janë ndërtuar komplekse të shumta pallatesh, në të cilat banojnë qytetarë të shumtë. Si rrjedhojë procesi i suburbanizimit, vendbanimet fshatare në afërsi të qyteteve po shndërrohen gradualisht në lagje administrative qytetare, madje po shndërrohen në vendbanim për banorët e qyteteve *(Canaj, E; Mazniku, L., 2008: 91).* Pra me rritjen e numrit të popullsisë brenda kufinjve të qytetit, shfaqet herë pas herë nevoja për zgjerimin e kufijve administativ të qytetit dhe dukuria e shfaqjes së proceseve të ndryshme urbane. Ajo që do të vihet re gjatë studimit është fakti se, proceset e ndryshme që në botë kanë gati një shekull që ekzistojnë, në Republikën e Shqipërisë dhe kryesisht në Tiranë brenda 30 viteve do të shikojmë kalimin nga njëri te tjetri ose bashkë ekzistencën e tyre në të njëjtën periudhë, duke patur një kahje të kundërt me ato të vendeve të zhvilluara. Siç dihet ne kemi jetuar një proces të vrullshëm urbanizimi.

Studiuesi Artan Fuga pohon se rritja e madhe e numrit të popullsisë sjell dëme edhe popullsisë së metropolit, përderisa këtu krahu i punës shtohet me shifra marramendëse, ndërsa hapësira ekonomike është tej mase me një natyrë strukture shërbimesh. Nuk ka punë, njerëzit përplasen bërryl më bërryl me njëri-tjetrin, qyteti ngushtohet, humbet hapësirat e gjelbra dhe peisazhin, zhurmat shtohen, tensionet sociale dhe stresi shtohen (Gazeta Standard., 2009: 15). Qyteti, si proces historiko-zhvillimor, është formuar nga individë të cilët jo domosdoshmërisht i bashkon lidhja e gjakut, por tempulli ku mblidhen për të kryer praktikat spirituale dhe veprimtari të tjera të përbashkëta. Tempulli përcjell praninë e një orientimi shpirtëror e kulturor të caktuar. Nuk ekziston asnjë qytetëtim shkruan Johan Pelushi pa përvojën të shprehur në kulturën e tij (*Pelushi, J., 2000:5)*.

E rëndësishme është të theksohet se në procesin e migrimit duhet patur parasysh jo vetëm kushtet e infrastrukturës së vendbanimit të ri, por edhe përshtatja me nënkulturën e re. Riorganizmi i hapësirave urbane, sistemimi i banesave dhe i grupimeve shoqërore të ndryshme në zona të caktuara, përcaktohen jo vetëm nga rritja e vrullshme e popullsisë së ardhur, nga gjendja ekonomike e saj, nga mangësitë e theksuara në infrastrukturën urbane, por edhe nga marrëdhëniet shoqërore përgjithësisht të tensionuara, me kriza që herë pas here janë ashpërsuar deri në prag të konflikteve sociale me armë *(Dervishi, Z., 2001 (a):35)*.

Kështu, kultura të ndryshme ndikohen nga faktorë të ndryshëm, si ato gjeografikë, sociakulturorë, ekonomikë, historikë, fetarë, etj., prandaj dhe nuk kanë të njëjtin nivel zhvillimi të kulturës. Disa prej këtyre vlerave kulturore trashëgohen brez pas brezi, disa të tjera, si për shembull, barazia, drejtësia, ndershmëria, individualizmi, konkurenca, fryma kolek-

tive, ndikohen edhe nga nxitjet e politikave të ndryshme. Vlera të tilla janë si të thuash, 'të padukshme' dhe përgjithësisht kanë qëndrueshmëri të lartë (Williams, R., 2001:24). Këtë problematikë e trajton edhe Samuel Huntington në librin e tij "Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror". Ai thekson: "... marrëdhëniet midis popujve para së gjithash janë marrëdhënie midis kulturash e qytetërimesh. Që nga koha e shfaqjes së qytetërimeve, marrëdhëniet midis tyre kanë evoluar. Në kohët e hershme, kontaktet mes tyre ishin të kufizuara, thuajse nuk ekzistonin, me disa përjashtime të vogla. Qytetërimet ishin të ndara në kohë e hapësirë, të ndara gjeografikisht, çka i dallonte më shumë në strukturat e tyre sociale e psikologjike. Qytetërimi i Andeve dhe ai Mezo-amerikan nuk kishin kontakte mes njëri-tjetrit dhe me qytetërimet e tyre deri në vitin 1500 të Erës së Re. Qytetërimet e hershme në luginën e Tigrit dhe Eufratit, Indit e Lumit të Verdhë me gjithë afërsinë gjeografike, nuk kanë bashkëvepruar" *(Huntington, S., 2004: 65)*.
Disa dukuri dhe prije të urbanizimit janë shfaqur njëkohësisht në disa qytete të Shqipërisë pas vitit 1990. Në këtë kohë do të shfaqet kudo njoftimi "e zënë" brenda qytetit dhe në rrethinat, i shkruar dukshmëm në mure, në dyer të ndryshme, në ndërtesa shtetërore të dala jashtw funksionit, madje edhe në zona ushtarake. Kjo fjalë trishtuese, irrituese dhe e frikshme në të njëjtën kohë për qytetarët e Shkodrës ishte simbol mjaft i çuditshëm që tregonte se dikush me forcën e tij, jashtë çdo lloj rregulli ligjor dhe moral pushton tokën që nuk është e tij ose një objekt që nuk e ka ndërtuar vetë, duke e konsideruar atë si të tij *(Kroni, M., 2011:106)*. Ky përshkim i studiuesit Mehdi Kroni, i cili paraqet situatën e krijuar pas vitit 1990 në qytetin e Shkodrës, mund të themi që ka qenë i njëjtë edhe në Tiranë. Ku banorë të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë zaptuan toka dhe ndërtesa të ndryshme në kryeqytet dhe nëpët muret e tyre shkryhej fjala "e zanun" ose "e zënë".
Pas vitit 1990 ka një ndyshim të procesit dhe lëvizjes së njerëzve. Prirja për t'u dukur, mendojmë se është psikologji dhe praktikë pothuajse te të gjithë banorët e rinj. Dikur, shkruan studiuesi Mehdi Kroni, "kur një malësor ose katunar vinte në qytet për ndonjë punë, ose në raste të veçanta edhe për të banuar, ai dallohej menjëherë si i tillë: nga mënyra se si vishej, si ecte, nga mënyra se si komunikonte me të tjerët, si ushqehej, si jetonte në shtëpi, si i rriste fëmijët etj. Ndërsa sot nuk mund të dallohet lehtë një gjë e tillë. Sidomos të rinjtë janë shumë më të kujdesshëm për të mos i lënë gjë mangut modelit në dukje të të riut qytetar" *(Kroni, M., 2011:112)*. Pra ajo që vihet re është fakti se tanimë jetojmë në një shoqëri të globalizuar në të cilën njerëzit japin e marrin duke ndryshuar edhe stilin e tyre të jetesës. Ajo që del në pah nga studimi është fakti se gjatë viteve të fundit migrimi është më i menduar mirë, zakonisht më parë emigron një anëtar i familjes në një shtet të huaj duke siguruar të ardhurat e nevojshme që e gjithë familja të stabilizohet me banim në Tiranë. Qyteti ka një ndikim shpirtëror dhe është i aftë të ndryshojë jetën e një njeriu. Ai përdor fuqinë e tij për ta mbajtur njeriun në të dhe ndryshon jetën e tij, madje, gjithë jetën e tij dhe jo vetëm shtëpinë e tij *(Ellul, Jasques.,1970:9)*.
Studiuesja, Saskia Sasen duke analizuar zhvillimin bashkëkohor të ekonomisë botërore vë në dukje një rol të ri strategjik të qyteteve të mëdha si Nju Yorku, Londra, Tokio. Këto qytete nga qendra tregtare ndërkombëtare kanë marrë disa veçori të reja. Ato janë shndërruar në qendra të hartimit të politikës për ekonominë globale, janë burim kryesor për firmat financiare dhe të specializuara të shërbimit, janë qendra të prodhimit dhe të novacionit në këto industri të porsa zgjeruara, janë tregjet ku blihen, shiten produket e industrive financiare dhe të shërbimit. E veçanta e qytetit global nuk është prodhimi i të mirave materiale, por krijimi i shërbimeve të specializuara që kërkohen nëpër botë, si dhe krijimi i risive financuara dhe tregjeve (*Sassen, S., 1991:10-12)*.
Pra migrimi i popullsisë nga të gjithë qytetet e krahinat e Republikës së Shqipërisë drejt metropolit do të shoqërohej me problematika nga më të ndryshmet, duke filluar me infrastrukturën e qytetit, rrugët, kanalizimet, furnimizmin me ujë të pijshëm, shtimin e ndërtimeve, shkatërimin e godinave të vjetra,

mungesën e kopshteve dhe shkollave, me rritjen e papunësisë dhe kriminalitetit etj.
Ajo që vihet re është rritja e shkallës së dendësimit të godinave, veçanërisht të pallateve të banimit. Rritja e mbipopullimit ka shtuar ndjeshëm vështirësinë e kalimtarëve dhe automjeteve për të përdorur rrugën. Veçanërisht në zonën e Komunës së Parisit mungojnë përgjithësisht trotuaret e gjerë dhe ka vështirësi të mëdha të përdorimit të tyre nga nënat e reja me karroca fëmijësh. Ndërsa trafiku i rënduar paraqitet i tillë pothuaj në të gjitha rrugët e Tiranës. Gjithashtu nga studimi del se korsitë e biçikletave sjellin rëndim të trafikut. Trafiku më i rënduar zakonisht është gjatë ditëve me shi. Shqetësuese për jetën në kryeqytet është mungesa e parkingjeve publike, numri i madh i bar-kafeve edhe në katet e para të pallateve, të cilat bëhen shumë shqetësuese për banorët e tyre prej muzikës së lartë ose ndotjeve të tjera. Rrugët e amortizuara si dhe trotuaret e ngushtë gjithashtu kanë sjellë shqetësime të konsiderueshme për jetën e përditshme të banorëve të Tiranës qofshin ata banorë më të hershëm ose të rinj të kryeqytetit. Mungesa ende e ujit të pijshëm në rrjet, i cili vijon të jetë me kufizime si dhe kanalizimet e pamjaftueshme sidomos në lagjet e reja dhe kryesisht periferike të qytetit, gjithashtu e vështirësojnë jetën normale të banorëve të tyre. Problem është gjithashtu edhe mungesa e këndeve të lojrave për fëmijët. Problematika të tjera që dalin nga analizimi i përgjigjeve kanë të bëjnë me rrugët e papastruara dhe era e rëndë e vendgrumbullimit të mbetjeve urbane në lagjet më periferike ashtu edhe anash rrugëve kryesore të qytetit, mungesa e parqeve dhe e zonave të gjelbërta, ndotja e madhe e ajrit. Një problematikw e renditur si shumë shqetësuese janë zhurmat si nga ndërtimet (kryesisht gjatë orëve të natës), ashtu edhe nga banorët.
Përgjatë viteve të fundit sipërfaqet e gjelbëruara janë zvogëluar. Shumica e lulishteve janë zhdukur. Në to janë ngritur godina të reja shumëkatëshe. Pak blloqe të pallateve të reja kanë lulishte dhe këndе lojërash për fëmijë. Shumica e tyre kanë bar-kafe, furra buke, njësi shitje për mallra të ndryshme etj. Në lagjet e kryeqytetit janë të pranishme të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike për ciklet, nga çerdhet deri tek shkollat e mesme. Me zgjerimin e kufijve urbanë të qytetit, gjatë viteve të fundit është shtuar numri i institucioneve arsimore. Duke qenë se gjatë viteve të fundit në disa zona të qytetit është shtuar numri i pallateve, dhe rrjedhimisht edhe të banorëve, shkollat ekzistuese i zhvillojnë mësimet me dy turne dhe me një numër të madh nxënësish nëpër klasa. Një problematikë e tillë shfaqet edhe në grupet e kopshteve, duke i detyruar prindërit të zgjedhin institucionet private në mënyrë që fëmijët të jenë në grupe më të vogla, duke qenë se koha që kalon një fëmijë në kopësht është më e madhe se ajo në shkollë.

Procesi i urbanizimit në Republikën e Shqipërisë është shoqëruar me dukuri dhe problematika të ndryshme, të cilat kanë patur ndikim në kushtet dhe mënyrën e jetesës së popullsisë si në fshat ashtu edhe në qytet. Në thelb të urbanizimit është migrimi dhe emigrimi i popullsisë, që vazhdon edhe në ditët e sotme të jetë çështje shumë e rëndësishme në shoqërinë tonë. Pra përderisa popullsia ndryshon vazhdimit vendbanimin atëherë edhe problemet do të jenë më të dukshme dhe më të pranishme.

Literatura

Canaj, Elidana; Luljeta Mazniku: Sociologji rurale, "KRISTALIN-KH", Tiranë 2008.

Dervishi, Zyhdi: Urbanizimi i jetës së popullsisë fshatare apo ruralizimi i qyteteve? Rasti i Tiranës; "Politika dhe shoqëria", Tiranë 2001.

Ellul, Jacques: The meaning of the city; "William B. Eerdmans Publishing Company", Michigan, 1970.

https://www.un.org/development/population/.

https://sq.wikipedia.org/wiki/Tirana.

Gazeta Standard 4 Nëntor 2009.

Gottdiener M.; Hutchison. R.: The new urban sociology, "Westview Press", Colorado, 2006.

Huntington, Samuel: Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror, LOGOS-A, Shkup 2004.

Pelushi, Joan: Tempulli, Nr.1-2, Shtëpia botuese 'Konti', Korçë 2000.

Kroni, Mehdi: Vështirësi dhe sfida të integrimit të banorëve të ardhur pas vitit 1990 në qytetin e Shkodrës, Revista shkencore akademike Lente Sociologjike, Vëllimi I, Nr. 1 (1):99-119, "Emal", Tiranë, 2011.

Sassen Saskia: The global city; "Princeton University Press", 1991.

Williams Raimond: The sociology of culture, The University of Chicago Press, 1995.